



UNMIK/REG/2008/3
14 janar 2008

RREGULLORE NR. 2008/3

**PËR NDRYSHIMIN E RREGULLORES SË UNMIK-UT NR. 2001/19
MBI DEGËN E EKZEKUTIVIT TË INSTITUCIONEVE TË
PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë sipas Rezolutës nr. 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren e ndryshuar nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), të datës 25 korrik 1999, për autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë,

Duke vepruar në përputhje me Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 15 maj 2001),

Pasi që është shpallur Rregullorja e ndryshuar nr. 2001/19 për themelimin e Degës së Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë e datës 13 shtator 2001, Rregullorja nr. 2002/5 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 e datës 2 mars 2002 dhe Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2005/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/9 e datës 16 mars 2005,

Duke marrë parasysh konsultimet me partitë politike dhe koalicionet që kanë udhëhequr formimin e Qeverisë, pas zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007, dhe vendimet përkatëse të Kuvendit të Kosovës të nxjerra në seancën inauguruese të 9 janarit 2008,

Me qëllim të ndryshimit të nenit 1 dhe 2 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 dhe të shtojcës I të saj, për arsye të shtimit të postit të zëvendëskryeministrit të dytë,

Nxjerr si në vijim:

Neni 1
Ndryshimi

Duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/19 ndryshohet si në vijim:

(a) Në fjalinë e parë të nenit 1.2.1, fjalët “një zëvendëskryeministër” zëvendësohen me fjalët “deri në dy zëvendëskryeministra”. Rrjedhimisht, fjala “zëvendëskryeministri” zëvendësohet në tërë tekstin me fjalën “zëvendëskryeministrat”.

(b) Në nenin 1.2.2, fjala “zëvendëskryeministri” zëvendësohet me fjalën “një zëvendëskryeministër.”

(c) Në nenet 1.2.3, 1.4, 2.1 (a) dhe në shtojcën I, në titullin dhe tekstin e pjesës A, fjala “zëvendëskryeministri”, zëvendësohet me fjalën “zëvendëskryeministri(at).”

Neni 2
Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon çfarëdo dispozite të ligjit në fuqi që nuk është në përputhje me të.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 14 janar 2008.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm

SHTOJCA C

ORGANIZATAT DHE TË TJERAT QË NUK PAGUAJNË AKCIZË

Akciza nuk paguhet nga si në vijim:

- (a) Misionet e jashtme diplomatike dhe konsullore;
- (b) Organizata e Kombeve të Bashkuara apo cilido nga organet e saj, duke përfshirë UNMIK-un, KFOR-in, organizatat ndërkombëtare ndërqeveritare dhe agjencitë qeveritare nuk paguajnë akcizë për mallrat që përdoren për qëllime zyrtare dhe
- (c) Kontraktorët e UNMIK-ut, agjencitë e specializuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe KFOR-i, të cilët importojnë mallra që përdoren vetëm nga ata kontraktorë lidhur me përmbushjen e kontratave të tyre me UNMIK-un, me agjencitë e specializuara të Organizatës së Kombeve të Bashkuara apo me KFOR-in.

